



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 5783 / Prot. 11

Laç, më 26 . 12 . 2023

VENDIM

Nr. 45 datë 19 / 12 / 2023

“MBI NDARJEN E BURSAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM  
PARAUNIVERSITAR DHE ARSIMIT BAZË PËR VITIN MËSIMOR 2023 – 2024”

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, në shkresën Nr. 6470/95Prot. datë 20.11.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024” sipas së cilës numri i bursave për Bashkinë Kurbin është 50 (pesëdhjetë) si dhe në kërkesën e Zyrës Vendore të Arsimit Kurbin Nr. 871Prot. datë 05.12.2023 “Për mbështetje financiare” të nxënësve me tendencë braktisje shkolle, sipas listës bashkëlidhur. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga nxënësit e interesuar që vazhdojnë arsimin e mesëm dhe arsimin bazë, si dhe shqyrtimin dhe miratimin nga Komisioni i Arsimit të Këshillit Bashkiak, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe pas propozimit nga Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

Të miratojë ndarjen e bursave të plota për nxënësit e arsimit të mesëm parauniversitar dhe gjysëm bursave për nxënësit e arsimit bazë me tendencë për braktisje shkolle, pasqyruar sipas kriterëve përkatëse në tabelën bashkëlidhur keti vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e keti vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA

Adresa: Lagja Nr.2, Laç



KRYETARJA E KESHILLIT

Edlira LLESHI

E-mail bashkiakurbini@gmail.com